



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 851/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagjja Kalabria, rr. “Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit “S-B...”, Sh.p.k., me seli në Fushë Kosovë, rr. “.....”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Fellanza M. Cacaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.213/2019, të datës 02.05.2019, të Përmbartuesit Privat Zija Bala, me seli në Pejë, jashtë seancës me datën 30.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “S-B...”, Sh.p.k., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.213/2019, të datës 02.05.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.213/2019, i datës 02.05.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala.

A r s y e t i m

Kreditori, Dogana e Kosovës ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit “S-B...”, Sh.p.k, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartimor Aktvendimit të Doganës së Kosovës, Sektori i Lojërave të Fatit, me numër 03.3\_601703847/17\_P\_L, i datës 26.11.2018, i formës së prerë me datë 26.12.2018 dhe i ekzekutueshëm me datë 26.01.2019, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të të taksës së akcizës, t’ia paguaj shumën prej 1,680.00 €.

Përmbartuesi Privat Zija Bala, me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, me datë 02.05.2019, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 213/2019, me të

cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, Aktvendimit të Doganës së Kosovës, Sektori i Lojërave të Fatit, me numër 03.3\_601703847/17\_P\_L, i datës 26.11.2018.

Kreditori në propozimin për përmbartim të datës 02.05.2019, ka kërkuar që të detyrohet debitori “S-B...”, Sh.p.k, t’ia paguaj kreditorit Dogana e Kosovës, detyrimin në emër të taksës të akcizës në shumën prej 1,680.00 €, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, me bllokimin e llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimin, vlerësimin, shënimin e përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, përmbartimin në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimin e sendeve të luajtshme, kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet tjera të krijuara, sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori përmes përfaqësueses së autorizuar, ka parashtruar prapësim me shkrim, në të cilin ka deklaruar se Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Lojërave të Fatit, me numër 03.3\_601703847/17\_P\_L, është nxjerrë me datë 26.11.2018, ndërsa propozimi për përmbartim është dhënë me datë 02.05.2019, e nëse gjykata kompetente nuk merr vendim deri më datë 13.12.2020, duhet të pushoj procedura, siç parashihet shprehimisht në nenin 43 par. 6 të Ligjit 05/L-087, ngase pas kalimit të këtij afati propozimi për përmbartim do të jetë i pabazuar. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovohet ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata konstaton se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në*

*bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbarimor Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Lojërave të Fatit, me numër 03.3\_601703847/17\_P\_L, i datës 26.11.2018, në bazë të të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Lojërave të Fatit, me numër 03.3\_601703847/17\_P\_L, i datës 26.11.2018, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Lojërave të Fatit, me numër 03.3\_601703847/17\_P\_L, i datës 26.11.2018, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Sektori i Lojërave të Fatit, me numër 03.3\_601703847/17\_P\_L, i datës 26.11.2018, është bërë i formës së prerë me datë 26.12.2018 dhe i ekzekutueshëm me datë 26.01.2019.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.851/22, datë 30.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.